



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.3/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Partia Ashkalinjve për Integrim (PAI), me seli në Lipjan, të paraqitura kundër vendimit nr. 104-2021 i datës 15.01.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 18.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet e palejuar apeli Anr.3/2021 i datës 16.01.2021, i ushtruar nga subjekti politik Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me nr. 104-2021 i datës 15.01.2021, që ka të bëjë me nominimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) në Komunitat: Prishtinë, Suharekë dhe Prizren.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 16.01.2021, ka pranuar apelin Anr.3/2021 i ushtruar nga subjekti politik Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 104-2021 të datës 15.01.2021, për shkak të mos aprovimit të emërimit të anëtarëve të KKZ-ve, nga subjekti i tyre politik në komunitat Prishtinë, Suharekë dhe Prizren për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 14 shkurt 2021. Subjekti politik PAI në apelin e parashtruar pretendon se me këtë vendim është dëmtuar subjekti i tyre politik edhe pse janë parti parlamentare anëtarët e saj nuk janë përfshirë në KKZ në komunitat e lartcekura. Parashtruesi i apelit në vazhdim thekson se duke u bazuar në Ligjin Nr.03-L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës neni 67, përbërja e KKZ-ve dhe kualifikimi i Anëtarëve si dhe në nenin 67 paragrafi 1, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në përgjithësi ka (7) anëtarë, ky numër sipas tyre mund të rritet nëse numri i subjekteve politike që kualifikohen për të qenë pjesë e komisionit është më i madh, ndërsa sipas nenit 67 paragrafi 3, KQZ-ja duhet ti përpiqet ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet.

Parashtruesit i apelit thekson se duke i marrë për bazë ligjin dhe nenet e lartcekura konsiderojnë që vendi i anëtarit në KKZ në komunën e Prizrenit, Suharekës dhe Prishtinës i takon atyre si parti e vetme parlamentare e komunitetit Ashkali nga legjislatura e fundit e Kuvendit të Kosovës, andaj të njëjtit theksojnë se komuniteti Ashkali në Prishtinë, Suharek dhe Prizren duhet të përfaqësohet nga të nominuarit e PAI-së si parti e vetme e këtij komuniteti në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga zgjedhjet e fundit parlamentare.

KQZ-ja, përmes përgjigjes në apel, ka theksuar se bazuar në nenin 63.6 të LZP-së vendimet e KQZ-se nuk i nënshtrohen ankesës përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj, pasi që apelimet ndaj vendimeve të KQZ-së në PZAP janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 i LZP-së. Me propozim për panelin, që apeli të hedhet si i palejuar për arsye se vendimi i apeluar nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të apelojnë në PZAP. Ndërsa tek nominimet e subjektit politik PAI, KQZ në përgjigjen e saj thekson se ka marrë për bazë nenin 67 paragrafi 3 të LZP-së, përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune, duke marrë për bazë edhe rezultatet e atij subjekti për atë komunë, si dhe nenin 67 paragrafi 9 i LZP-se, ku pavarësisht paragrafit të këtij neni, ne rast se kërkohet KQZ-ja ka kompetenca për te emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKZ-se te cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni.

Paneli, në kuptim të nenit 3 paragrafi 8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ankesën Anr.3/2021 e datës 16.01.2021, vendosi ta trajtojë si apel, duke e vlerësuar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat.

Paneli, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, gjeti se:

Apeli është i palejueshëm

Me nenin 63 paragrafi 6 i LZP-së, përcaktohet se: *“Vendimi i Komisionit nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj”*.

Me nenin 64 paragrafi 2 pika a) i LZP-së, përcaktohet se: *“KQZ-ja i përgatitë dhe shpall rregullat, format dhe procedurat zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj”*, ndërsa me pikën b) të këtij neni përcaktohet se: *“KQZ-ja, i publikon të gjitha rregullat e miratuara, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore dhe i bënë ato të arritshme për opinionin”*.

Apelimet zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- a) *Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;*
- b) *Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;*
- c) *Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;*
- d) *akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;*

- e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe
- f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

Nga interpretimi i dispozitave të lartcekura rezulton se vendimet e KQZ-së, nuk janë të apelueshme përveç nëse parashihen qartë më ligj. Në këtë rast vendimi i apeluar i KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat mund të apelohehen e të cilat janë të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 122 paragrafi 1 pikat a), b) c), d), e) dhe f), për arsye se vendimi i apeluar hynë në kategorinë e vendimeve të karakterit teknik menaxhues të KQZ-së, e i cili vendim është nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 64 të LZP-së, e i cili vendim nuk prek apo cenon një të drejtë themelore të votuesve.

Meqenëse vendimi i apeluar siç u cek më lartë hynë në kuadër të vendimeve teknike organizative, Paneli nuk u lëshua në vlerësimin meritore të çështjes, pasi vlerësoi se ky vendim nuk mund të apelohehet për arsyet e cekura më lartë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.3/2021 datë 18.01.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 4 i LZP-së,